



Marco Fantini, Eureka!, wood, stone, found objects, mirror, 145x65x90cm, 2007

EXQUISITE CREATURES

opening 27th – April 6th 2009
28 April - 16 May 2009

Marco Faniti, Ziso Kamberaj

Marco Fantini was born in 1965 in Vicenza, Italy. In 1983 he attended the Faculty of Architecture at University of Venice following Italo Zannier's photography courses among others. Influenced by Diane Arbus' works he started a personal research concentrating on themes of *diversity* and *alienation*. In 1989 Marco Fantini traveled to Mexico where he spent 2 years working in Enrique Norton's architectural studio, and studying Mexican muralist painting. His first oil paintings date back to this period. In the lastest years he has worked also in video installation and sculpture projects.

Ziso Kamberaj, nasce a Tirana nel 1965. Si diploma nel 1988 presso l'Accademia di Belle Arti di Tirana al livello di Bachelor of Fine Arts.

Ha esposto in decine di mostre in tutto il mondo tra le quali: Gallery Mall – Londra; Galleria Pedro Figary - Uruguay; Galleria di Casona - Santa Barbara - Argentina; Parlamento Europeo - Strasburgo; Galleria Mak - Maribor - Slovenia; Mediterranea – Bari, onufri National Gallery di Tirana Albania,

Njeriu, zhurma dhe heshtja

Ekspozita me artistët Marco Fantini dhe Ziso Kamberaj është e hapur në Vlorë. Ja si një art i mirë është në funksion të njerëzimit edhe nga pikëpamja politike. Nga ana tjetër, ishte zhurma, një gumëzhimë e pareshtur e vizitorëve të veshur ultrashik dhe me një interes intensiv në gjithçka

Ekspozita me artistët Marco Fantini dhe Ziso Kamberaj është e hapur në Vlorë. Ja si një art i mirë është në funksion të njerëzimit edhe nga pikëpamja politike. Nga ana tjetër, ishte zhurma, një gumëzhimë e pareshtur e vizitorëve të veshur ultrashik dhe me një interes intensiv në gjithçka

nga Ridvan Peshkopia

Më 29 prill u hap në **Promenade Gallery** ekspozita "Exquisite Creatures" (Krijesa Delikate) e italianit Marco Fantini dhe shqiptarit Ziso Kamberaj, kuruar nga Pino Bonano i Universitetit të Klagenfurtit.

Meqë nuk jam një kritik arti, por një njeri i interesuar në teori sociale, dhe meqë jam nga ata që mendojnë që kërkimi i sublimes estetike nuk është domosdoshmërisht i pavarur nga misioni social i artit, po hedh këto shënime për të treguar se si një art i mirë është pashmangshmërisht në funksion të njerëzimit edhe nga pikëpamja politike.

Sidomos nga pikëpamja politike. Sigurisht, nëse me politikë nuk kuptojmë vetëm politika partiake apo shtetërore apo ndërkombëtare, por edhe duelin e përjetshëm individ/strukturë që po tenton të shfaqet formalisht edhe mes bijve të shqipes që kanë jetuar përjetësisht mes këtij dueli, por në injorancë të lumtur për ekzistencën e tij.

Ja tani ku i gjejmë të dy këto koncepte tek rivalizojnë dhe harmonizojnë në një ekspozitë të vetme (e ç'ka të veçantë këtu: a nuk urrehen e duhen ata në të njëjtën mënyrë, në çdo qelizë të shoqërisë njerëzore?)

Marco Fantini shikon Njeriun. Mes zhurmës, rrëmujës, një ambienti të ngjyrosur selektivisht (artistikisht), të qartë dhe të mjegullt, këtu dhe atje, të lumtur dhe të trishtë, të djeshëm dhe të sotëm, intensiv apo të shpenguar, në këmbë apo i ulur, serbes apo i turpshëm, gjendet Njeriu. Nuk mund t'i shpëtosh dot; ai zotëron mbi të gjithë ambientin përreth, edhe kur nuk është figura më e madhe në të.

Duke sunduar botën e tij apo botën e telajos ku ndodhet, Njeriu i Marco Fantini-t, në fakt, sundon botën.

Nuk ka arsye për t'u trembur, mund të mos jetë një diktator apo një gangster; mund të jetë thjesht një mjek, muzikant apo shkencëtar. Edhe ata kanë botëra për të sunduar: ne veçse përfitojmë kur ata e sundojnë mirë botën e tyre, ashtu siç përfitojmë nga Fantini që sundon mirë botën e tij.

Nuk jam i sigurt nëse vetë Fantini është i vetëdijshëm për vlerën filozofike përtej vlerës artistike në artin e tij. Mendoj se po, ngaqë personalisht më mungon ndjenja e humorit kur flitet për çështje të tilla dhe nuk dua që gjërat të mbeten në duar të rastësisë.

Në këtë rast kemi mes nesh një relike të Iluminizmit, të cilin e kemi keqinterpretuar deri në zhubrosje, por që tani është koha t'i kthehemi edhe një herë, pasi postmodernizmi, ashtu si vrasësit masivë nëpër shkolla apo tregje të Amerikës, pasi "vrau" lart e poshtë kë i doli përpara, tani ia ka kthyer edhe vetes (ua lehtësoi këtë punë kundërshtarëve që, në fakt, nuk ia kishin ngenë as për ta vlarë). Ja se si gjethet (kanoçet e vjetra të monumentalizuara në artin instalativ) nuk na kanë lënë të shohim pyllin (Njeriun). Njohja fillon këtu dhe për të - edhe njohja e kanoçeve.

Ziso Kamberaj më surprizon me të anasjellën (për herë të parë nuk po them "të kundërtën"). Atij i intereson Struktura. Kjo Strukturë për të është kontekst ku ai vendos rraqet e bodrumit të shtëpisë.

Në atë bodrum, apo në cilindo nga ambientet tona postsocialiste, këto rraqe do të ishin kujtesa ose të një trashëgimie kulturore otomane të shoqërisë sonë, ose sendet e tejpërdorura në mjerimin material socialist.

Konsumerizmi ynë bashkëkohor i lëshuar nga zinxhirët, i ka zhvleftësuar ato tashmë nga ana praktike, ndërsa stërpërdorimi i tyre nuk ka lënë më asnjë mesazh estetik që ato mund të transmetojnë. Fati i tyre është tashmë i përcaktuar: harresa dhe/ose shkatërrimi. Konteksti ynë i përditshëm është armiku i tyre fatal.

Këtu ndërhyjnë Kamberaj me një kontekst të ri, atë estetik. Duke i vendosur në disa plane të çuditshme monokromatike, autori i shndërron ato objekte të pavlera në thelbin e rrugëtimit të tij drejt sublimes absolute, të cilën, më pas, ai na e transmeton tek ne përmes telajove të plotësuar jo vetëm me këto plane dhe sende mbi to, por edhe të një morie detajesh teknike, estetike e artistike (hile të zanatit) për të plotësuar shfaqjen (revelimin) e sublimes që ai dërgon tek ne si një gjysmëzot nga jetëbota e tij e veçuar (rekluzive).

Detajet në këto telajo luajnë një rol të dyfishtë: nga njëra anë krijojnë një kontekst material, ku sendet - rraqe të tilla si vazo, poçe qeramike, dritare si kuadrate drite apo thjesht njollë e bardhë krem e kufizuar qartë, tiganë e tepsi të kallajisura nga kallajxhiu i qytezës apo autori vetë, lule të disa frymëzimeve e qytetërimeve, mjete shkrimi midis së kaluarës romantiko-primitive dhe të tashmes teknologjiko-cinike, jetojnë në botën e tyre kontekstuale, me të vetmin ndryshim se tani ne jemi më të vëmendshëm ndaj saj; nga ana tjetër, është konteksti artistik, i panjohur më parë

për ne, i krijuar nga artisti dhe i shfaqur tek ne sipas dëshirës (tekave) së tij.

Ky është një kthim fantastik tek modernizmi i lartë me të gjithë elementët e tij politikë, filozofikë dhe artistikë. Fantini proteston komiken në deklarinimin e vrasjes së artit dhe individit nga postmodernizmi; Kamberaj ironizon sarkazmën patetike të shkatërrimit të strukturalizmit prej dekonstruksionit postmodernist.

Pas 2500 vjet grindjesh pa pajtim, ontologjitë e tyre kanë shpallur më në fund paqen në këtë ekspozitë, për të qëruar hesapet me një armik aspak të denjë dhe kalimtar (Charles Altieri e ka vërejtur rënien e postmodernizmit që në 1998-ën).

Esellia dhe ekuilibri perfekt filozofik e artistik e bën kundërvënien e artistëve ndaj skizofrenisë postmoderniste një lojë cinglash. Fantini thotë: ja ku është objekti im sublim - Njeriu; Kamberaj thotë: ja ku është sublimja ime - gjithçka e rrezikuar nga konsumerizmi bashkëkohor. E ç'mund të thotë artisti postmodernist përballë tyre? Që ai ka vrarë sublimen dhe që ai nuk është më artist?

Po çfarë është atëherë?

Një mbledhës kanoçesh mes plehrave të Sharrës? Jo, falemnderit! Meqë nuk jam pronar i ndonjë fonderie ku riciklohen kanoçe alumini, ato objekte nuk përbëjnë më asgjë për mua. A ke ndonjë mesazh të lartë për të më transmetuar diçka që unë nuk e di dhe nuk e kam ndjerë më parë?

A ma udhëheq dot rrugën drejt së vërtetës dhe së bukurës absolute? Unë bindem edhe më tepër që ajo ekziston pasi shikoj përpjekjet shkatërraqe të artistit postmodernist (pak punk, pak gothik/metalar, pak travesti e pak nga të gjitha bashkë) për ta mohuar atë.

Sepse Fantini dhe Kamberaj më udhëheqin mua nëpër një botë magjike që e ndiej dhe perceptoj, por nuk e materializoj dot.

Ata më hapin dritare që unë e di se ekzistojnë, drejt një bote që unë e di se është, por që pa ta unë nuk e arrij dot. Sepse unë jetoj në një jetëbotë tjetër dhe përpiqem të sundoj atë, teksa sundimin e jetëbotës artistike ua kam lënë artistëve.

Unë nuk jetoj në komunizëm dhe nuk dua t'i bëj të gjitha punët sipas parimit marksist të zhdukjes së ndarjes së punës (do të isha shumë kureshtar ta shihja Marks-in të punonte çdo mëngjes peshkatar në Ndërmarrjen e Midhjeve Sarandë, shofer furgoni në drekë dhe profesor universiteti në mbrëmje).

Kësisoj, unë pres që secili të bëjë punën e tij, dhe, sigurisht, artisti të vetën. Sepse ai është i pajisur me dhuntinë kimiko-biologjike apo hyjnore për ta gjetur atë që quhet talent, i cili tek shumë prej nesh mungon.

Megjithatë, nuk mendoj se ne jemi krejt pa rol në këtë kontekst estetiko-social. Kësisoj, le të kthehemi tek kontributi ynë (akustik) në rastin konkret dhe në përgjithësi.

Ajo që mbretëroi në hapje të ekspozitës së Fantini-t dhe Kamberajt ishte zhurma, një gumëzhimë e pareshtur e vizitorëve të veshur ultrashik dhe me një interes intensiv në gjithçka përreth (burrat sidomos për gjokset gjysmë të zhveshura të grave ose për pijet në banak, ndërsa gratë për çmimet e kravatave të burrave dhe të dyja palët së bashku për kamerat).

Por, unë u pushtova nga një dashuri e pakufishme për atë kolektiv, sepse ata ishin njerëzit që kishin zbritur nga tablotë e Fantini-t ose ata ishin njerëzit që unë do t'u propozoja që të ngjiteshin në ato tablo dhe të bëheshin personazhe të tyre. Ajo zhurmë zbriste dhe rikthehej tek ato punime me një akustikë perfekte.

Por ky është vetëm një pasqyrim i interpretimit që unë bëra në ato çaste; në asnjë mënyrë nuk duhet konsideruar si performancë që bën punimet e Fantini-t. Këto punime qëndrojnë aty po aq imponuese edhe në heshtje, porse zhurma u bën mirë atyre, shton në kontekstin e tyre.

E kundërta është për punët e Kamberajt. Që të mund të kapësh sublimen në to, punët e tij kanë nevojë për një heshtje solemne që shndërrohet në një vlerë të shtuar të heshtjes së tablove në kufijtë e zeros absolute të fizikës njutoniane.

Kjo nuk do të thotë, gjithsesi, se ne duhet të kërkojmë heshtjen në mënyrë performative, pra të marrim pjesë në krijimin e veprës artistike duke heshtur.

Puna, mesazhi, mjeshhtëria, sublimja janë në zotërim të autorit. E vetmja gjë që na lejohet është interpretimi. E ndieja atë interpretim në heshtje dhe jam gati i sigurt që edhe të tjerët do t'i kishin shijuar më mirë ato punë në heshtje.

Por, teksa shihja njerëz që tek-tuk e kuturu shfaqnin edhe ndonjë interes për punimet dhe nguleshin përpara tyre, iu nënshtrova intersubjektivitetit të interpretimit dhe i dhashë vetes premtimin për t'u kthyer përpara tablove të Kamberajt në një kohë tjetër, në heshtje.

Kur e bëra këtë, kuptova se kisha të drejtë (po gënjej pakëz këtu, sepse unë e dija paraprakisht këtë qëkurse i kisha parë më parë këto punë në shtëpinë e autorit).

Ika i mbushur nga ekspozita, sepse luftën time për sublimen estetike po e luftonin me sukses ata që ishin më të pajisur se unë për atë luftë, ata që kishin talentin e duhur.

Tani unë mund t'u kthehem punëve të mia pa vrarë mendjen për një përpjekje individuale drejt sublimes estetike, të cilën e dua, e lakmoj, por nuk e arrij dot i vetëm.

Ka disa njerëz që vazhdojnë ta hapin rrugën deri aty, ta arrijnë, zotërojnë dhe shpërndajnë atë drejt shoqërisë në mënyrë shfaqore (reveluese); këta janë intelektualët-artistë, sipas një përkufizimit tim.

Dikur intelektualët qenë edhe revolucionarë që vdisnin barrkadave, pasi më parë kishin frymëzuar masat për t'u ngritur në luftëra çlirimtare apo revolucione që fillojnë me rrafshimin e pabarazive dhe mbarojnë me vetëvrasje; dikur ata qenë tipikja europiano-lindore.

Sot, në shoqëritë tona postmaterialiste dhe nën presionin e teknokracive e burokracive, nuk mund

të kërkojmë më kaq shumë nga intelektualët.

Kësisoj, pasi e kemi ngushtuar pritshmërinë ndaj tyre, përqendrohemi vetëm në pritshmëri të ndërtuara sipas rregullash loje të ditura: ata jetojnë në jetëbotën e tyre gjysmëhyjnore dhe ne presim prej tyre udhëheqje në ato fusha ku ata dinë. Për të tjerat, ne i sundojmë vetë jetëbotët tona. /Shekulli/

Publikuar: 18.05.2009 | 18:47

THE PROMENADE GALLERY

VLORE

Bulevardi Skele Uji i Ftohte
AL 9401, Vlorë ALBANIA

+355 69 29 12 759

+39 347 72 86 203

All general enquiries should be sent to

info@thepromenadegallery.org

<http://www.thepromenadegallery.org>

Opening Hours:

Tuesday - Saturday from 10 AM - 8 PM

Summer Hours: Tuesday - Friday from 10 AM - 7 PM until July 17th
and by appointment